

VENDIM
Nr. 100, datë 17.6.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR
SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “a” dhe 98, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5 dhe 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a.,

konstatoi:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” .

- në nenin 14 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, parashikohet se: Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Enti Rregullator i Energjisë, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kontratës “Për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti